

VENDIM
Nr. 372, datë 26.12.2023

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SWISS BALANCING POOL” SHPK NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d” dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2303/5 prot., datë 19.12.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Swiss Balancing Pool’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2303 prot., datë 17.10.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 310, datë 30.10.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.11.2023 dhe 2.11.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 9.11.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 2302/5 prot., datë 1.11.2023, ERE iu drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të paplotësuar/plotësuar pjesërisht, shkresë e cila u kthye nga shërbimi postar, me shënimin “I panjohur” ndaj në vijim shoqëria u njoftua nëpërmjet adresës së *email*-it.

- Duke qenë se shoqëria “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. nuk kishte depozituar dhe as komunikuar asnjë përgjigje, referuar kërkesave të paplotësuara të nenit 9, pika 1.3, germa “a” dhe pika 2.4, germa “c”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nga Drejtoria Teknike u dorëzua relacioni me nr. 2303/3 prot., datë 23.11.2023, për t’u trajtuar në mbledhjen e radhës.

- Në vijim, shoqëria, me shkresat nr. 2302/7 prot., datë 23.11.2023 dhe nr. 2302/8 prot., datë 24.11.2023, përpara shqyrtimit të relacionit në mbledhjen takuese, ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit të saj, duke bërë me dije se nuk ka marrë njoftim zyrtar as përmes *email*-it dhe as përmes shërbimit postar, por nga kërkimi në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, u informua për fillimin e procedurave në lidhje me licencimin e shoqërisë në veprimtaritë e tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar dhe nevojës që mund të lindë për ndonjë korrespondencë të mundshme, u depozitua relacioni me nr. 2303/4 prot., datë 24.11.2023, mbi të cilin me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 359, datë 1.12.2023, u vendos të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimarrjes përfundimtare mbi licencimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën me nr. 2302/10 prot., datë 6.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë mbi vendimarrjen e Bordit për zgjatjen e afatit, dhe i ka sjellë në konsideratë se për të zhvilluar

korrespondencën përkatëse në rrugë shkresore me ERE-n shoqëria duhet të bëjë me dije një adresë të vlefshme.

- Në vijim subjekti me shkresën me nr. 2302/11 prot., datë 12.12.2023 ka konfirmuar adresat përmes së cilave do të zhvillohen korrespondencat në rrugë shkresore dhe elektronike.

- Duke qenë se shkresa u dërgua vetëm me qëllim saktësimin e adresave, në vijim shoqërisë i është dërguar shkresa me nr. 2302/12 prot., datë 13.12.2023, pasi subjekti duhet të përcjellë vërtetimin lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, se ka shlyer të gjitha detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, dokumentacion i cili është përcjellë në ERE me shkresën e fundit me nr. 2302/13 prot., datë 14.12.2023, nga shoqëria.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-(pesë)-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti